

# Meningokoku B

## Çfarë është sëmundja e meningokokut?

Sëmundja e meningokokut është një sëmundje e rëndë që shkaktohet nga bakteret *Neisseria meningitidis*. Ky infeksion bakterial mund të shkaktojë meningjit (inflamacion i cipës rrethuese të trurit) dhe septicemi (helmim i gjakut).

Ekzistojnë grupe të ndryshme të bakteve *Neisseria meningitidis* që shkaktojnë sëmundjen e meningokokut. Përpara futjes së vaksinës së meningjtit C (MenC) në vitin 2000, grupet B dhe C ishin shkaktarët e shumicës së rasteve të sëmundjes së meningokokut në Irlandë. Falë vaksinës MenC kundër bakteve të meningokokut të grupit C, numri i rasteve të sëmundjes së meningokokut për shkak të bakteve të grupit C është ulur në mënyrë dramatike. Tani shumica e rasteve shkaktohen nga bakteret e meningokokut të grupit B.

## Si preken njerëzit nga sëmundja e meningokokut?

Bakteret e meningokokut mund të jetojnë në pjesën e pasme të fytit ose në hundë. Shumica e njerëzve që mbartin këto baktere (bartësit), mbeten mirë, por ata mund t'i përhapin bakteret tek të tjerët përmes kollitjes, teshtitjes ose puthjes. Kontakti i ngushtë personal me një bartës ndonjëherë çon në infektim. Nevojiten shumë orë kontakt të ngushtë personal për t'u infektuar, sepse bakteret nuk mbijetojnë gjatë jashtë trupit.

Sëmundja e meningokokut mund të shfaqet në çdo moshë, por shkalla më e lartë e sëmundjes së meningokokut shfaqet te fëmijët nën 1 vjeç. Sëmundja e meningokokut B është më e zakonshme te fëmijët nën një vjeç. Grupi tjetër me rrezikun më të lartë janë të rinjtë e moshës 15-19 vjeç. Në Irlandë, rreziku i infektimit është më i lartë në dimër dhe në fillim të pranverës.

## Cilat janë simptomat e sëmundjes së meningokokut?

Fillimi i sëmundjes së meningokokut mund të jetë shumë i shpejtë. Simptomat e sëmundjes së meningokokut përfshijnë temperaturë, ngrirje të qafës, dhimbje koke, dhimbje kyçesh dhe skuqe të lëkurës. Nëse mendoni se fëmija juaj ka shenja të sëmundjes së meningokokut, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore nga mjeku juaj i përgjithshëm ose departamenti i urgjencës pediatrike më të afërt. Në disa raste, veprimi i shpejtë për të marrë ndihmë mjekësore mund të bëjë diferencën midis jetës dhe vdekjes.

Sëmundja e meningokokut është një sëmundje shumë serioze kërcënuese për jetën.

Nga personat që sëmuren me meningokok:

- 1 në 20 persona do të vdesë
- 1 në 10 persona që shërohen, do të ketë një aftësi të kufizuar të madhe, si për shembull shurdhim, dëmtim të trurit ose humbje të gishtërinjve të duarve, gishtërinjve të këmbëve, duarve, këmbëve, krahëve ose gjymtyrëve të poshtme.

Diagnostikimi i hershëm çon në trajtimin e hershëm me antibiotikë dhe një shans më të madh që personi të shërohet plotësisht. Diagnostikimi i hershëm është çelësi, kështu që nëse dyshoni se dikush mund të ketë meningjit ose septicemi, kërkoni menjëherë vëmendje mjekësore.

Më shumë informacion ofrohet në <http://www.meningitis.org/ireland>

## Kush duhet ta marrë vaksinën e meningokokut B (MenB)?

Sëmundja e meningokokut B parandalohet me anë të vaksinimit.

## HSE - Zyra Kombëtare e Imunizimit

Të gjithë fëmijëve u ofrohet vakcina MenB në moshën 2 dhe 4 muajshe, me një dozë përforcuese të vaksinës MenB që jepet në moshën 12 muaj.

Fëmijët nën 1 vjeç janë më të rrezikuar nga infektimi me sëmundjen e meningokokut B dhe duhet të vaksinohen.

### **Kur është futur vakcina e meningokokut B (MenB) në kalendarin parësor të vaksinimit në fëmijëri?**

Vaksina MenB është futur në kalendarin e vaksinimit në Irlandë për të gjithë fëmijët e lindur nga data 1 tetor 2016, sepse fëmijët nën një vjeç janë në rrezikun më të lartë të sëmundjes së meningokokut B.

### **A ka ndonjë kalendar plotësues për fëmijët në moshë më të madhe?**

Komiteti Kombëtar Këshillues i Imunizimit\* rekomandon një program plotësues për fëmijët derisa ata të arrijnë moshën dy vjeçare.

Në mars të vitit 2020, Komiteti Kombëtar Këshillues i Imunizimit rishikoi kalendarin plotësues të vaksinimit në fëmijëri, komiteti vendosi që tani vakcina MenB nuk duhet të rekomandohet si vaksinë plotësuese kur një fëmijë mbush moshën 2 vjeç, përveçse kur fëmija është në një grup në rrezik.

Udhëzimet u ndryshuan, sepse rreziku i infeksionit MenB, i cili është më i zakonshëm para moshës një vjeçare, zvogëlohet me shpejtësi pas moshës 2 vjeç (i njëjti rekomandim është dhënë në MB).

Megjithatë, prindërit mund të zgjedhin t'i vaksinonjë fëmijët e tyre në moshë më të madhe, nëse dëshirojnë.

Vaksina MenB duhet të merret privatisht përmes një mjeku të përgjithshëm nga prodhuesi.

(\*Grupi i ekspertëve të Komitetit Kombëtar Këshillues të Imunizimit (NIAC) i përbërë nga specialistë mjekësorë nga Kolegji Mbretëror i Mjekëve të Irlandës bën rekomandime për politikën e vaksinimit.)

### **Fëmija im ka humbur një dozë të vaksinës MenB, a mund të vaksinohet akoma?**

Çdo fëmijë që ka humbur një dozë të vaksinës MenB mund ta marrë ende atë nga mjeku i përgjithshëm deri në moshën 2 vjeç.

Kontakttoni sot klinikën e mjekut tuaj të përgjithshëm për të caktuar një takim.

### **A mbron vakcina e meningokokut B (MenB) nga të gjitha sëmundjet e meningokokut?**

Vetëm infektimi nga meningokoku B parandalohet nga vakcina MenB. Llojet e tjera të infeksionit të meningokokut nuk mbulohehen nga kjo vaksinë.

Vaksina e meningokokut C për mbrojtjen kundër infeksionit të meningjitit C u jepet fëmijëve në Irlandë që nga viti 2000. Që nga futja e vaksinës në fund të vitit 2000, numri i rasteve të sëmundjes së meningokokut, për shkak të baktereve të grupit të meningokokut C, është ulur në mënyrë dramatike. Numri i rasteve të raportuara ka rënë nga 139 në vitin 2000 në vetëm 6 në vitin 2014, një ulje prej 96%. Në vitin 2021 u konfirmuan 10 raste të sëmundjes së meningokokut

**Është shumë e rëndësishme të qëndroni vigjilent për simptomat e sëmundjes së meningokokut, sepse jo të gjitha llojet e saj mbulohehen nga vaksinat. Duhet të kërkohet kujdes urgjent mjekësor nëse shfaqen simptoma.**

## HSE - Zyra Kombëtare e Imunizimit

### Kush nuk duhet ta marrë vaksinën e meningokokut B (MenB)?

Ka shumë pak njerëz që nuk duhet ta marrin vaksinën MenB. Fëmija juaj nuk duhet ta marrë vaksinën nëse ka pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj një doze të mëparshme të vaksinës ose ndonjë pjese të vaksinës, duke përfshirë edhe vaksinën e tetanozit.

### Çfarë duhet pritur pas marrjes së vaksinës së meningokokut B (MenB)?

Pas marrjes së vaksinës, fëmija juaj mund të ketë siklet, skuqje ose ënjtje rreth vendit ku është bërë injeksioni. Ai mund të jetë nervoz dhe të ketë temperaturë.

Nga fëmijët që imunizohen:

- 1 në 2 do të ketë temperaturë
- 1 në 10 do të ketë siklet, skuqje dhe ënjtje në vendin e injeksionit ose do të ketë temperaturë
- 1 në 100 mund të ketë temperaturë të lartë
- Fëmijët zakonisht shërohen nga këto efekte anësore të vogla brenda një ose dy ditësh

Efektet anësore të rënda (alergjia e rëndë) janë shumë të rralla.

### Si të menaxhoni temperaturën pas vaksinës MenB

Kur vaksina MenB jepet me vaksinat e tjera të fëmijërisë në vizitat 2 dhe 4 mujore, ekziston një rrezik më i lartë që foshnja të zhvillojë temperaturë. Temperatura pas vaksinës MenB zakonisht rritet gjatë 6 orëve të para dhe më pas ulet deri në 24 orë, kur shumica e etheve do të zhduken.

Fëmijëve në vaksinat e tyre 2 dhe 4 muajsh duhet t'u jepen 3 doza paracetamol lëng për foshnja pas çdo vizite, për ta ulur këtë temperaturë.

Doza 1 duhet të jepet në momentin e vaksinës ose direkt **pas** vaksinës MenB.

Doza 2 duhet të jepet 4-6 orë pas dozës 1 dhe

Doza 3 duhet të jepet 4-6 orë të tjera pas dozës 2.

Fëmijëve duhet t'u jepet një dozë prej 2,5 ml (60 mg) paracetamol lëng suspension për foshnja.

Është e rëndësishme që fëmijëve të mos u jetë dhënë paracetamol përpara vaksinimit, pasi mjeku i përgjithshëm ose infermierja e klinikës do të duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë nëse fëmija është mirë për të marrë vaksinat.

Paracetamoli nuk e ndalon zhvillimin e temperaturës te fëmija, por megjithatë paracetamoli do të ndihmojë në zvogëlimin e temperaturës dhe shkurtimin e kohës së saj te fëmija.

Fëmijëve më pak se 4 kg (8 lb 8oz) në kohën e vaksinimit duhet t'u jepet një dozë më e vogël e paracetamolit lëng për foshnja. Flitni me mjekun tuaj të përgjithshëm për të llogaritur dozën që i nevojitet fëmijës suaj.

Paracetamoli nuk ka nevojë të jepet në mënyrë rutinore në vizitën 12 mujore për vaksinën MenB, pasi rreziku i temperaturës te fëmijët pas vaksinës në këtë moshë nuk ndryshon nga rreziku i temperaturës pas çdo vaksine tjetër rutinë në fëmijëri.

Ibuprofeni nuk rekomandohet.

Nuk rekomandohet përdorimi i paracetamolit supost.

### **Si funksionon vaksina e meningokokut B (MenB)?**

Vaksina MenB përmban ekstrakte nga bakteret e meningokokut B. Vaksina funksionon duke e bërë sistemin imunitar të trupit të përgjigjet nëse një fëmijë është në kontakt me bakterin e meningokokut B, pa shkaktuar sëmundje.

### **Sa efektive është vaksina MenB?**

Vaksina MenB ka rezultuar të jetë shumë efektive dhe e sigurt, duke siguruar 88% mbrojtje kundër llojeve të baktereve MenB.

### **Ku mund të mësoj më shumë?**

Flitni me një punonjës profesionist shëndetësor të besuar dhe vizitoni [www.immunisation.ie](http://www.immunisation.ie)